

Vaksina COVID-19

Hollësi që duhet të dini për vaksinën e COVID-19*



Është e **SIGURT**

Vaksinat COVID-19 në përdorim janë autorizuar nga FDA dhe rekomanduar nga Komisioni Këshillimor për Praktikën e Vaksinimit të CDC.

Vaksina ka ndjekur të njëjtët hapa të testimit dhe miratimit që përdoren për të gjitha vaksinat. Ato u krijuan me shpejtësi, por asnjëherë nuk kanë anashkaluar rregullat e sigurisë. Për më tepër informacion për sigurinë e vaksinës vizitoni mass.gov/COVIDVaccineSafety



Është **FALAS**

Vaksina COVID-19 jepet falas për të gjithë njerëzit nga qeveria federale.

Mund t'ju kërkohet informacioni i sigurimit shëndetësor me qëllim që ofruesi që ju bën vaksinën të faturorë siguracionin. Megjithatë, ju nuk do të merrni faturë. Nëse nuk keni siguracion, përsëri keni të drejtën e vaksinimit falas.



Nevojiten **DY** doza për tu vaksinuar **PLOTËSISHT**

Pa qenë vaksinuar plotësisht, përsëri mund ta merrni dhe përhapni COVID-19.

- **Vaksina Pfizer:** të paktën **21 ditë** pas dozës së parë
- **Vaksina Moderna:** të paktën **28 ditë** pas dozës së parë
- **Vaksina Johnson & Johnson (Janssen):** vetëm **një** dozë

Jo të gjithë vaksinohen kur vaksinoheni ju. Ndërsa e dimë se vaksinat ulin shumë rastet dhe simptomat, ne përsëri jemi duke mësuar për mbrojtjen që sigurojnë vaksinat. Vazhdoni të mbani maskën, lani duart, ruani distancën dhe shmangni grupimet edhe pasi të jeni vaksinuar plotësisht.



Dy dozat tuaja duhet të administrohen nga i **NJËJTI VEND**

Ju duhet ta merrni dozën e dytë të së njëjtës vaksinë në të njëjtin vend me të parin.

Përpara se të lini takimin për dozën e parë, rregulloni ose konfirmoni se kur do të lini takimin e dytë (për Pfizer dhe Moderna).



Shikoni se kur mund të vaksinoheni në mass.gov/covidvaccinephases

Masaçusetsi i ofron vaksinat e COVID-19 në faza, duke u fokusuar në paanësinë dhe sigurinë.

Kalendari fokusohet në ruajtjen e kapacitetit të sistemit shëndetësor, duke siguruar paanësinë në aksesin e shëndetësisë dhe peshën e COVID-19, si dhe në mbrojtjen e popullsisë së prekshme. Çdo fazë ka grupet e përparësisë. Për grupet e përditësuar të përparësisë, vendet e punës dhe kushtet shëndetësore që kanë të drejtën, vizitoni mass.gov/COVIDVaccinePhases

* Ky informacion u përditësua së fundi më 15/3/21 lidhur me vaksinat Moderna, Pfizer dhe Johnson & Johnson (Janssen).

